



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 130/13
Prishtinë, më 12.11.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami Albana Fetoshi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi: Sali Asllanaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ymer Havolli, Driton Qehaja, Adrian Zalli nga FKPK-ja, Lukas Fischer, Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi nga GIZ

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.10.2013;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Punësimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie e Sociale;
6. Shqyrtimi i Raporti me rekomandime të Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja njoftoi me përfundimin nga kryesisë së Kuvendit që është ngarkuar Komisioni për shqyrtimin e një kërkesë të RTK-së, është fjala për vendim që ka marrë Qeveria sipas ligjit për menaxhimin e financave publike. Në këtë vendim i janë ndarë disa mjete RTK-së dhe kisha kërkuar nga ju që kjo të jetë për shqyrtim në pikën të ndryshme.

Naser Osmani nuk pajtohem që kjo të jetë në rendin e ditës, kjo çështje nuk ka të bëjë fare komisionin, nuk është pjesë e buxhetit dhe nuk është pjesë e asaj që ish dashtë mu trajtu nga Ligji për menaxhimin e financave publike. Qeveria i ka nda me një vendim mjetet dhe le ti qet mjetet drejtpërdrejtë. Kryesia e Kuvendit ka mundur të njoftohet, por në rast se komisioni do të duhej të trajtojë, atëherë rekomandimi duhet të dërgohet në seancë. Kjo konsideroj që është thjeshtë manipulim me deputetët e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetarja çdo përfundim që vjen nga kryesia ne jemi të obliguar si komision që ta shqyrtojmë edhe unë jam e mendimit që nuk është objekt shqyrtimi i Komisionit një çështje e tillë, mirëpo këtë ne e vendosim me rekomandimin të cilin mundë ta japim në fund.

Me dy vota kundër (Naser Osmani , Xhevdet Neziri) miratohet rendi i ditës me plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, dt. 14.10.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje

3. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014

Kryetarja Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e ka paraqit kërkesën për miratimin e dy taksave vjetore, si për taksën operacionale edhe për taksën investive ashtu siq është e paraparë me ligjin për fondin pensional të Kosovës. Sipas kërkesës se Fondit Pensional e shohim që tek taksa operacionale ka një propozim për ulje prej 0.15 % në 0.13 % kurse ka një rritje te taksa investive prej 38% ne 40%. Arsyetimi i Fondit Pensional është janë rritur më shumë mjete në menaxhim dhe kërkohet të ketë më shumë mjete në taksën investive. Nëse shohim pasqyrën të cilën e ka dorëzuar fondi pensional ka lëvizje të buxhetit, diku kemi ulje e diku ngritje të cilat janë paraparë për mallra dhe shërbime, për investime kapitale mirëpo kryesisht kjo rënia ka ardhur për shkak të rënies të pjesës që ka të bëjë me shpenzimet kapitale.

Ymer Havolli kërkesës së bordit drejtues për takse menagjuese i ka paraprirë miratimi i buxhetit vjetor për vitin e ardhshëm. Bordi drejtues ka vlerësuar si te dobishme propozimin e Komisionit te Investimeve se për vitin 2014 në bazë të rrethanave që mbretërojnë në treg do të ndryshohet strategjia e investimeve dhe do të bëhet një diversifikim më i madhë i aset menaxherëve megjithëse pritet të ketë performancë të kënaqshme nga investimet. Si pasoj e kalimi ne strategjinë e menaxhimit te riskut investues kërkohet angazhimi i menaxhuesve te ri te mjeteve dhe si rrjedhojë shtimi i buxhetit për investimin ne këta aset menaxher. Kjo strategji e menaxhimit të riskut gjithsesi është me e shtrenjtë se strategjia aktuale e diversifikimit te riskut por njëkohësisht është me më pak risk dhe me më shumë siguri per kontribuesit. Taksa totale e kërkuar per vitin 2014 është e njëjtë me atë të nje viti më parë, që do të thotë që kontribuesit e Fondit Pensional do të ngarkohen njësoj edhe ne vitin 2014 sikurse ne vitin 2013 me 0.53 % . Ndryshimi i vetëm do të jetë në nivelin e mjeteve që shkojnë për financimin e investimeve e cila ne vitin 2014 eshte projektuar të jetë 0.40% sa ishte p.sh ne vitin 2013 0.38 % kurse për shpenzimet operacionale taksa e kërkuar menaxhuese është 0.13% dhe ka zvogëlim për 2 % nga viti paraardhës.

Kryetarja meqenëse eshte kërkuar të rriten mjetet për fondin për investime është planifikuar të rritet shuma e mjeteve që do të investohen dhe menaxhohen pasi që shumica e aset menaxhere të prezantuar në tabelë janë partner të fondit për disa vite me radhë. A është bërë përpjekje negociimi me këta aset lidhur me normën e tarifës per menaxhimin dhe investimin e mjeteve, apo normat e ofruara nga ata janë fikse dhe te pa negocijshme?

Ymer Havolli sigurisht se ne e negociojmë edhe kushtet e kontraktimit me aset menaxheret në pikëpamje të pyetjes që e shtruat ju lidhur me kushtet për shkallëzimin e taksave dhe investimeve. Tregjet financiare njohin një shkallë në të cilën mbërrin investimet p.sh mbërrin investimet në një aset menaxher në 100 milion atëherë fillon procesi i negocimit të taksës menaxhuese për tarifat të cilat ata i kërkojnë nga ne dhe ky është një proces të cilit ne për çdo 3 muaj bordi i Fondit e shqyrton këtë, ne raste kur kemi arrit këtë konsensus dhe sigurisht kur i mbërrin këto ne kemi edhe tarifa më të ulta nga ofruesit.

Naser Osmani keni arritur shumë gati 1 miliard euro në menaxhim dhe shteti duhet të mendojë se qfarë të bëjë me këto mjete, nuk është vetëm qeshtja e plasmanit të mjeteve që ju i plasoni me kamat simbolike, qeshtja është çka duhet bërë me këtë fond a duhet të ndryshoj ligji. Mirëpo për tarifat që keni kërkuar unë jam pro.

Kryetarja tek taksa operationale kisha një dy pyetje është qeshtja tek paisjet e zyreve keni bërë dyfishim të kërkesës buxhetore ndoshta është mirë me na dhënë një arsyetim. Po e shohë këtu që është rimëkëmbja pas fatkeqësive qira që është kërkuar të rritet në 18,000 euro dhe një pozicion tjetër qiraja e zyrës me sqarue për çka është fjala këtu. Po ashtu në pjesën e tretë të tabelës të buxhetit operacional keni paraparë shpenzime për harduerët 50,000 euro dhe softuerët dhe licencat 25,000 euro dhe përkundër faktit që thuhet që është kompletuar infrastruktura dytësore harduerike dhe licenca softuerike për realizimin e planit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë. Ku është arsyeja që është kërkuar prapë për këto mjete?

Adrian Zalli sqaroi se deri në vitin e kaluar kemi pasur një sistem ose asnjë vend alternativ me të cilin të dhënat që i kemi në zyrën qendrore të mbahen diku tjetër në rast të ndonjë zjarri apo ndonjë shkatërrimi masiv apo total të zyrës qendrore. Kjo ka ardhur si pasojë e rekomandimit të auditorëve tonë që ne duhet me pas një zyre alternative dhe prandaj e kemi kontraktuar një zyre tjetër dhe kemi blerë edhe harduerin dhe softuerin për rimëkëmbje të fatkeqësive. Po ashtu kemi pasur një ngritje relativisht të madhe mbi marrëdhëniet me publikun kjo ka të bëjë si pasojë e dy gjërave me rendësi së pari është rritur numri i kontribuesve që jemi të obliguar t'i dërgojmë pasqyrat, e dyta është sepse Autoriteti Rregullativ i Kosovës neve na ka dërguar një letër ku na ka informuar që do të rriten tarifat për dërgesa të thjeshta për 50%.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandimi

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës investive prej 0,40% dhe taksën operationale prej 0,13%, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2014.

4. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012

Kryetarja njoftoi se nga Avokati i Popullit ka ardhur një shkrese që avokati nuk ndodhet në Kosovë për këtë periudhë dhe kanë kërkuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. Propozoj që shqyrtimi i raportit të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

Komisioni njëzëri vendosi që shqyrtimi i Raporti vjetor financiar i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012, të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Punësimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie e Sociale

Kryetarja me këtë projektligj është paraparë që të formohet një agjenci e punësimit që në kuadër të Ministrisë së Punës, d.m.th departamenti i cila ka ekzistuar me përpara pra departamenti i punësimit tash shëndrrohet në një Agjenci të Punësimit. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë ndonjë kosto shtesë buxhetore, kurse formimi i agjencionit ka një kosto shtesë buxhetore, mirëpo kostoja është e përballuar për buxhetin e Kosovës.

Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Raporti me rekomandime të Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi administratën tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102

Naser Osmani mendoj që komisioni për legjislacion ka dhënë opinionin e vet por jo të bazuar në asnjë dokument, madje as në kushtetutë. Duke mos u bind prej rekomandimit që jep Komision për Legjislacion qëndrojnë edhe me tutje në rekomandimet tona, edhe për arsye të tjera sepse kemi të bëjmë me një afat kohor të limituar ku janë në pyetje trajtimi dhe diku 1400 lëndëve nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime të cilëve është propozuar t'iu vazhdohet mandati deri në fund të vitit 2014 dhe nëse e bëjmë me procedura të rregullta të emërimit të anëtarëve të bordit, nuk besoj që kjo mund të kryhet në një afat më të shpejt se katër deri në pesë muaj. Shtrohet pyetja se a keni bërë ndonjë punë për atë periudhë që mbetet përsëri nuk do të mjaftoj që të trajtohen 1400 lëndë?

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, me një votë Absetnim (Albana Fetoshi), asnjë Kundër dhe tetë vota Për Për (Safete Hadergjona, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj), Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk përkrahu rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe qëndron prapa amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional.

8. Të ndryshme

8.1. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve financiare të RTK-së sipas Vendimit të Qeverisë

Kryetarja theksoi se Qeveria e Kosovës bazuar në ligjin e buxhetit 2013 ka bërë shkurtimin e mjeteve buxhetore për disa institucione që kanë pasur nënshpenzim deri në shtator, dhe ato mjete janë transferuar të disa institucione tjera të cilat kanë pasur kërkesa. Në mesin e këtyre institucioneve që kanë përfituar nga ndarja është edhe RTK-ja. Meqenëse RTK-ja është në kuadër të Kuvendit të Kosovës atëherë për tu bërë i mundur ekzekutimi i një ndarje të tillë, procedurat duhet kryer nga administrata e Kuvendit. Vendim ka dalë në Kryesinë e Kuvendit e cila e ka ngarkuar komisionin për ta shqyrtuar dhe unë mendoj se në komision nuk kemi çka me shqyrtue se nuk na ngarkon asnjë dispozitë ligjore që me shqyrtu një qeshtje të

tillë sepse përndryshe ish dashur ti shqyrtojmë edhe institucioneve tjera të pavarura. I vetmi rekomandim që mund ta japim ne është që administrata e Kuvendit ti respektoj procedurat në ekzekutimin e mjeteve.

Naser Osmani nuk është korrekte dhe as institucionale që kryetari i kuvendit të na sjell një dokument të tillë në Komisionin kryesor për të shqyrtuar diçka që nuk është në kompetencën e tij. Kjo ka mundur të kryhet në mbledhjen që e ka pas kryesia. E vërteta është që me këtë trajtim që po i bëhet RTK-së është edhe dhunim i këtij institucioni dhe shantazh i këtij populli që nuk po zgjidhet një herë e përgjithmonë financimi i këtij mediumi, dhe ky nuk është me institucion i pavarur medial po është bërë një institucion qeveritar dhe ndoshta duhet me ndërhy në ligj që le të dihet që RTK-ja është në shërbim të pushtetit pavarësisht kush është dhe kush do të jetë në pushtet. Kjo mënyrë e ndarjes nuk i ndihmon as RTK-së që kanë obligime aq të mëdha dhe nuk kanë mie i zgjedh problemet me 1 milion e as me më shumë miliona mirëpo këto janë qeshtje jo institucionale jo të shëndetshme për këto institucione të Kosovës që ndërhyhet sipas tekeve të momenteve të caktuar ti shpërblejnë apo tu bëjnë një kompenzim të një shërbimi që do ta bëjnë, prandaj edhe si të tillë e kundërshtoj atë.

Hykmete Bajrami dua ti përkujtoj të gjithë që LDK-ja një dite pasi është marrë vendimi arbitrar nga ana e qeverisë që në kohë të fushatës me u shkurt prej institucioneve 5.7 milion euro kemi reaguuar menjëherë. Pas kemi parë vendimin e qeverisë edhe kemi pa që shumë institucioneve i është sakatos buxheti në mënyrë që keto para të shkojnë atje ku PDK-ës i janë dashur më së shumti për fushatë. Pajtohem komplet siç e tha deputeti Osmani ne që sa kohë jemi duke ankuar që RTK-ja është bërë një televizion komplet politik i cili nuk është në shërbim të askujt tjetër prej qytetarëve të Kosovës përveç e partisë dhe e koalicionit në pushtet. Ne kemi pas edhe shpërndarje tjera buxhetore të cilat kanë shkuar pikërisht në komunat ku PDK-ja e ka ndje veten të rrezikuar. Rasti kur Qeveria me vendim ka vendosur që ti shpërblej të gjithë fermerët e komunës së Rahovecit nga 500 euro për një hektarë vresht dhe normal që ne nuk kemi asgjë kundër që të subvencionohen ata vreshtar dhe ata fermerë mirëpo ka dal qartazi që me këtë vendim qeveria ka blere vota e atyre njerëzve të cilët mundohen në mënyrë të ndershme të jetojnë me mundin dhe djersën e tyre, dhe definitivisht nuk isha pajtuar të jap voton për një aprovim të një vendimi të tillë.

Latif Gashi me vjen keq që kjo u shfrytëzua për fushatë dhe u diskutuan shumë gjera tjera nuk janë për tu diskutuar këtu, megjithatë ne kemi një përfundim që nënkryetari plotësisht ka të drejt që tha ne si komision nuk mund të marrim një vendim. Por në anët tjetër nuk pajtohem me nënkryetarin që tha se e ka dërguar kryetari i kuvendit, sepse nga shkresa kuptojmë se kemi të bëjmë me kryesinë kështu që për ata se a është e nevojshme me ju nda 1 milion euro është e nevojshme dhe qfarë prezantimi ka bërë RTK-ja gjatë fushatës është vlerësimi ne nuk jemi këtu për të bërë këto masa.

Albana Fetoshi çështja e parë që po me duket shumë absurde këtu është se si administrata e Kuvendit mundet me procedue një çështje nëse nuk merret vendim politik në Kuvend. Nëse kjo kërkesë nga Qeveria ka ardhur në Kuvend dhe ka kaluar përmes kryesisë do të thotë se aty është dashtë mu marr një vendim politik sa i përket kësaj çështje dhe nëse ata e kanë marrë një vendim politik dhe është kompetencë e kryesisë atëherë nuk e kuptoj pse duhet me ardhë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, nëse nuk është kompetencë e jona me shqyrtue një kërkesë të këtillë. Unë nuk e kuptoj se si është menduar që një kërkesë e Qeverisë të vijë në Kuvend të procedohet përmes administratës të Kuvendit dhe të anashkalohet komplet vendim politik që mund të merret ose në komisionin për Buxhet dhe Financa ose në kryesi.

Kryetarja propozoj që të nxjerrim një përfundim në që administrata e Kuvendit të respektoj procedurat sipas ligjit të menaxhimit të financave publike dhe ligjit për buxhetin dhe sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Latif Gashi propozoj që ne të nxjerrim një përfundim dhe t'ia dorëzojmë kryesisë më pas të vendos kryesia.

Kryetarja përfundimi jonë është që administrata e Kuvendit të respektojë procedurat për ndarjen e mjeteve financiare sipas vendimit të Qeverisë dhe në pajtim me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe ligjin për buxhetin.

Pas diskutimeve, Komisioni me dy vota kundër (Naser Osmani, Albana Fetoshi), asnjë Abstenim dhe shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Jelena Bontic, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama) nxori këtë

Rekomandim

1. Ministria e Financave dhe Administrata e Kuvendit të Kosovës të respektojnë procedurat për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.000 (një milion) euro në xhirollogarinë e Radio Televizionit të Kosovës, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.11/152 dt.18.10.2013.

8.2. Naser Osmani njoftoj se grupi punues ka përfunduar punën në monitorimin e zbatimit të ligjit për Lojërat e Fatit dhe raporti është i gatshëm për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Latif Gashi njoftoj po ashtu se grupi punues ka përfunduar punën në monitorimin e zbatimit të ligjit për Prokurimin Publik dhe raporti është i gatshëm për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja përfundoi: 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj